



Norwegian Embassy

EC
MA KOSOVA

KCSF
FONDACIONI KOSOVAR PËR SHIKIMIN CIVIL
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

EKO SHKOLLA

PËRMBAJTTJA

- Ndotja e Ajrit
- Intervistë "Mbrojtja e Ambientit"
- Grafikoni mbi Eko Shkollën



NDOTJA E AJRIT

Ndotja është një problem shumë aktual në vendin tonë. Ne po ballafaqohemi me lloje të ndryshme të ndotjes duke filluar nga mbeturinat e shumta dhe mosmenaxhimi i tyre e deri tek ndotja e ajrit i cili është esencial për jetesën tonë.

Meqenëse jemi duke hyrë në stinët e ftohta, koha kur më së shumti ndotet ajri ynë, atëherë ne si Klub i Ambientit duam ta ngrisim këtë çështje si shqetësim tonin. Për vite me radhë problemi i ndotjes së ajrit nuk po trajtohet me seriozitetin e nevojshëm dhe ne si banorë të këtij vendi po i përjetojmë pasojat e kësaj. Duke qenë se ndotja e ajrit në vendin tonë po arrin në shifra alarmante duke rrezikuar shëndetin nga ekspozimi i njerëzve në ambiente të hapura. Djegia e qymyrit dhe drurit si dhe gazrat e makinave dhe termocentraleve lirojnë grimca liron që mbesin pezull në ajër për periudha të gjata kohore dhe janë shkaktarë kryesor të sëmundjeve të shumta. Sëmundjet që shfaqen për shkak të ndotjes së mjedisit janë sëmundje kronike pulmonare, astma, kanceri i mushkërive, kanceri i lëkurës, helmimi nga plumbi, sëmundjet kardiovaskulare, goditjet në tru, alergjitë dhe shumë të tjera.

Serioziteti i çështjes së ndotjes së ajrit është shumë i madh prandaj ky shkrim nga ne duhet të shërbejë si një thirrje dhe një alarm për institucionet që të ndërmarrin masa urgjente për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe kthimit të vëmendjes tek shëndeti i popullsisë.

Viona Gashi, Klubi i Ambientit "Luciano Motroni"



Fig. 1 dhe fig. 2. Ndotja e Ajrit
<https://www.yahoo.com/news/kosovos-capital-breathing-harms-health-040452047.html>

Intervistë me z. Ismet Potera



1. Si ka ndikuar aktiviteti i njeriut në prishjen e balancit ekologjik ?

- Është faktori kryesor që ka ndikuar në balancin ekologjik.

Aktivitetet e tij, sidomos në dëmtimin e pyjeve, shfrytëzimin pa kritere

të resurseve ujore, mineraleve, bimëve etj., kanë ndikuar në balancën ekologjike.

Në shumë raste aktivitetet e njeriut kanë ndikuar në prishjen edhe të piramidës së ushqimit në natyrë.

2. Si është gjendja e ujit dhe e ajrit në Kosovë ?

- Gjendja e ujit dhe e ajrit janë nën nivele të standardeve për cilësinë e ajrit dhe të ujërave. Ende lumenjtë konsiderohen si bartës të mbeturinave, prandaj edhe hidhet gjithçka në to, nga mbeturinat shtëpiake deri tek ato të rrezikshme (vajëra, detergjente e kimikate). Ende nuk ka përfunduar sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza (rreth 70%) prandaj edhe kemi këtë gjendje të ujërave, si nënëtokësore ashtu, edhe më keq ato sipërfaqësore. Mungon një ndërgjegjësim i mirëfilltë për mbrojtjen e ujërave, por edhe zbatimi i ligjit ndaj ndotësve ende nuk zbatohet në masën 100%. Gjithashtu ajëri është tejet i ndotur, mbi nivelet e lajuara, dhe atë për disa arsye: e para, Kosova ende është në fazën e ndërtimit dhe të rindërtimit. Kjo shkakton pluhura të shumë grimcat e të cilit paraqesin ndotje dhe prishje të cilësisë së ajrit. E dyta, përdorimi i thëngjillit dhe i lëndëve të tjera drusore për ngrohje dhe për prodhim të energjisë. E treta, numri i madhë i veturave kryesisht dizel dhe relativisht të vjetra.

3. Çfarë duhet të ndërmarrim si shoqëri që të kemi një ambient më të shëndetshëm ?

- E para, duhet bërë një vetëdijësim të institucioneve për zbatimin e programeve dhe të politikave të mbrojtjes dhe të përmirësimit të mjedisit. E dyta, duhet një vetëdijësim i përgjithshëm dhe sensibilizim i qytetarëve për pjesëmarrje aktive në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Duhet një mobilizim i përgjithshëm institucional dhe qytetar për mbrojtje të mjedisit. Politikat mjedisore duhet të bëhen pjesë qendrore e zhvillimit të vendit. Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm duhet të bëhen pjesë përbërëse e politikave dhe programeve zhvillimore kombëtare. Bashkëpunimi në nivel rajonal dhe më gjerë duhet të jetë prioritet zhvillimor me fokus në ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike, mbrojtja e biodiversitetit etj.

4. Si bëhet menaxhimi i mbeturinave dhe si do të duhej të vepronim me to ?

- Menaxhimi i mbeturinave ka mangësi të mëdha. Ende nuk është kuptuar drejtë koncepti menaxhim i mbeturinave. Ky process duhet të fillojë nga momenti, burimi i krijimit të tyre deri në riciklim, ripërdorim ose depozitim. Ende grumbullimi i tyre është vetëm vendosja në arka mbeturinash dhe bartja në deponi. Ligji për mbeturinat, kujdesi dhe vendosja e tyre në vende adekuate, duhet të zbatohet në përpikëri. Duhet edhe në vetëdijësim i gjerë për menaxhim të tyre nga burimi deri në përfundim të tyre, si dhe krijimi i politikave dhe infrastrukturës për riciklim. Grumbullimi i mbeturinave, por edhe shtrirja e vetëdijësimit dhe zbatimit të ligjit duhet të shtrihen në të gjitha pjesët e vendeve, në të gjitha fshatrat. Duhet shtrirë edhe mekanizmat e grumbullimit dhe të bartjes, riciklimit dhe kompostimit.

5. A mund të na flisni për ndërlidhjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ?

- Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit është shtylla kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm. Vendosja e mjedisit, resurseve dhe politikave të shfrytëzimit të tyre në prioritet nacional është element i rëndësishëm i konceptit zhvillim i qëndrueshëm. Çdo projekt zhvillimor duhet patjetër të ndërlidhet me ndikimin e tij në resurset mjedisore, të cilat nuk janë vetëm të këtij brezi (tonat), por të brezit të ardhshëm. Prandaj kjo duhet bërë jo vetëm pjesë e programeve zhvillimore, por edhe pjesë e kurrikulave dhe programeve studimore, me moton: shfrytëzimi racional i çdo resursi natyror duke pasur parasysh çfarë po i'u trashëgojmë brezit të ri. Sidomos mbrojtja dhe kultivimi i biodiversitetit, resurseve ujore, pasurive nëntokësore duhet të bëhet bazuar në filozofinë e zhvillimit të qëndrueshëm.

GRAFIKONI mbi EKO SHKOLLËN

EKO SHKOLLA

Programi Eko Shkolla është fenomen në rritje, i cili inkurajon të rinjtë të përfshihen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë që ta mbrojnë atë në mënyrë aktive. Fillon në klasë, ai zgjerohet në shkollë dhe përfundimisht nxitë ndryshime në të mirë të komunitetit. Përmes këtij programi, të rinjtë përjetojnë një ndjenjë të arritjes për të qenë në gjendje të kenë një mendim në politikat e menaxhimit mjedisor të shkollave të tyre, duke i drejtuar përfundimisht ata drejt çertifikimit dhe prestigjit që vjen me dhënien e një Flamuri të Gjelbërt. Programi Eko Shkolla është një mënyrë ideale që shkollat të fillojnë në një rrugë domethënëse drejt përmisimit të mjedisit si në shkollë ashtu edhe në komunitetin lokal, ndërsa në të njëjtën kohë kanë një ndikim pozitiv për gjithë jetën në jetën e të rinjve.

Përfshinë të gjithë - I gjithë programi zhvillohet sipas një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin studentë, mësues dhe komunitetin lokal në përgjithësi.

Përmison mjediset shkollore - Programi Eko Shkolla është një mënyrë ideale që shkollat të fillojnë një rrugë domethënëse drejt përmirësimit të hapësirave mjedisore të një shkolle, ndryshim i cili në mënyrë të pashmangshme çon në një mjedis shkollor më të qëndrueshëm, më pak të kushtueshëm dhe më të përgjegjshëm.

Motivon - Eko Shkolla fton studentët të angazhohen në trajtimin e problemeve mjedisore në një nivel ku ata mund të shohin rezultate të prekshme, duke i nxituar ata të kuptojnë se ata me të vërtet mund të bëjnë ndryshime.

Përmison Qëndrimet - Eko Shkolla krijon tek studentët një ndjenjë të përgjegjësisë dhe kultivon një mentalitet të qëndrueshëm me përpjekjen të bëjnë vërtet ndryshime, duke e kaluar përfundimisht atë tek brezat e ardhshëm.

Përfshinë Komunitete - Eko Shkolla i kushton shumë rëndësi përfshirjes së komunitetit lokal që në fillim. Duke bërë kështu, mësimet që marrin studentët transferohen përsëri në bashkësinë ku ata marrin përsipër dhe çojnë në modele sjelljeje më të qëndrueshme, me përgjegjësi ndaj mjedisit, në të gjithë rrethin.

Lidh globalisht - Eko Shkolla lehtëson kontaktin midis institucioneve pjesëmarrëse jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtarisht. Këto lidhje ofrojnë një mundësi për shkollat të ndajnë informacionin mjedisor.

<https://www.ecoschools.global/how-does-it-work>

EKO SHKOLLA për Shkolla Ndërkombëtare

Programi Eko Shkolla është krijuar për t'u përshtatur të gjitha shkollave nëse ato janë çerdhe, shkollë fillore, shkollë e mesme, kolegji arsimor, universitet apo shkollë me nevoja të veçanta.

IFRASTRUKTURA E EKO SHKOLLËS



Të gjitha shkollat ndërkombëtare mund t'i bashkohen programit Eko Shkolla. Sidoqoftë, ekziston një ndryshim në ifrastrukturën Eko Shkolla në rastin e shkollave ndërkombëtare. Ky adaptim bën të mundur që shkollat ndërkombëtare në vendet pa një organizatë kombëtare të bashkohen me programin Eko Shkolla dhe të menaxhohen përmes Eko Shkolla ndërkombëtare.

Fig. 3. Infrastruktura e Eko Shkollës
<https://www.ecoschools.global/international-schools/about>

Siç tregohet edhe në figurën e mësipërme, shkollat ndërkombëtare në vende pa një organizatë kombëtare do të menaxhohen direkt nga shkolla ndërkombëtare. <https://www.ecoschools.global/international-schools/about>

Si funksionon EKO SHKOLLA

Programi i Eko Shkollës qëndron mbi tri shtylla kryesore: Struktura e 7 hapave, Temat e Eko Shkollës dhe Vlerësimi për Flamurin e Gjelbërt.

STRUKTURA E 7 HAPAVE

- hapi 1. Eko Komiteti
- hapi 2. Rishikimi i Mjedisit
- hapi 3. Plani i Veprimit
- hapi 4. Lidhja me Programin
- hapi 5. Informimi dhe Përfshirja
- hapi 6. Monitorimi dhe Vlerësimi
- hapi 7. Eko Kodi

TEMAT E EKO SHKOLLËS

- Biodiversiteti
- Energjia
- Qytetaria Globale
- Jetesa e shëndetshme
- Plehrat
- Jeta Detare
- Toka e shkollës
- Transporti
- Mbeturinat
- Uji

VLERËSIMI PËR FLAMURIN E GJELBËRT

- Aplikimi për Flamurin e Gjelbërt
- Ngarkimi i të dhënave
- Përgaditja për vizitë për vlerësimin e flamurit të gjelbërt
- Dita e vizitës për vlerësimin e flamurit të gjelbërt
- Dita pas vizitës për vlerësimin e flamurit të gjelbërt

<https://www.ecoschools.global/how-does-it-work>

PROGRAMI I EKO SHKOLLËS



Fig. 4. Programi Eko Shkolla
<https://www.ecoschools.global/how-does-it-work>

Klubi i Ambientit "Luciano Motroni"
Mehmet Pashë Devalla, 20000 Prizren

EC MA NDRYSHE

Adresa: Fehmi Lladrovci 94, 20000 Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 224 967 & +381 29 222 771

Email: info@ecmandryshe.org

Web: www.ecmandryshe.org:

Social media:

<https://www.facebook.com/ecmandryshe>

<https://twitter.com/ecmandryshe>

<http://instagram.com/ecmandryshe>

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

